



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 25.05.2023

**V E N D I M**

**Nr. 3, datë 25.05.2023**

**PËR**

***PËR PAJISJEN ME AUTORIZIME INDIVIDUALE TË SIPËRMARRËSIT ONE ALBANIA SH.A, PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZAVE 900 MHZ, 1800 MHZ DHE 2100 MHZ, PËR SHKAK TË RISHPËRNDARJES, ME QËLLIM SIGURIMIN E PËRDORIMIT EFIÇENT TË KËTYRE FREKUENCAVE***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>Z.</b>	<b>Tomi Frashëri</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Z.</b>	<b>Lorenc Bako</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 25.05.2023, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Autorizimeve, Drejtorisë Teknike dhe Drejtorisë Juridike dhe Integritit, shqyrtoi kërkesën me objekt:

*“Për pajisjen me Autorizime Individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja c e pikës 1 dhe pika 2, e nenit 75, të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (Ligji nr.44/2015);
3. Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”;
5. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 06, datë 31.03.2022 “Për miratimin e Planit të përdorimit të frekuencave”.
6. Rregullore nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”;
7. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”;

### **KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Shkresat e përbashkëta të sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe One Albania sh.a, me nr. 73/53 prot. (i AKEP), datë 09.03.2023 dhe nr. 73/59 prot., datë 15.05.2023.
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

### **V Ë R E N:**

1. Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe One Albania sh.a, me shkresat e përbashkëta me nr. 73/53 prot., datë 09.03.2023 dhe nr. 73/59 prot. datë 15.05.2023, kanë kërkuar rishpërndarjen e frekuencave të secilit nga brezat e 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, me qëllim përdorimin me efikasitet të këtyre frekuencave, si dhe kanë paraqitur një propozim sipas një ndarje të dakordësuar midis tyre për rishpërndarjen e secilit nga brezat, në dy pjesë, për të eliminuar ndarjen aktuale me disa pjesë.
2. AKEP ka pajisur këta dy sipërmarrës me Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave, për ndërtime dhe operimin e rrjeteve celulare. Referuar këtyre autorizimeve individuale, rezulton një ndarje me pjesë (copa) të ndryshme në secilin nga brezat e frekuencave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz. Kjo ndarje/copëzim, rezulton pasi operatorët kanë blerë sasi të ndryshme spektri, në vite të ndryshme, dhe është bërë më e theksuar pas bashkimit me përthithje të operatorit Albtelecom sh.a nga operatori One Albania sh.a.
3. Në kushtet kur tashmë në treg, janë vetëm dy operatorë celularë, kjo lloj ndarje e copëzuar e këtyre spektrave, e bën të nevojshme rishpërndarjen e tyre, në dy pjesë secili brez, me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të frekuencave të këtyre brezave, por pa ndryshuar sasinë e spektrit të dhënë me autorizime individuale nga AKEP dhe pa ndryshuar afatet e vlefshmërisë së autorizimeve për përdorimin e secilit spektër.
4. Zhvillimet teknologjike të sotme, mundësojnë shpejtësi të larta komunikimi nëpërmjet rrjeteve celulare dhe kjo ka bërë të nevojshme aplikimin nga operatorët celularë të spektrit në sasi me 5 MHz. Ndërsa përdorimi i spektrit me ndarje 200 KHz, përdoret vetëm në rrjetet e gjeneratave të mëhershme 2G. Këto mënyra përdorimi nga operatorët celularë, janë në përputhje me Autorizimet Individuale të lëshuara nga AKEP dhe në përputhje me VKM nr. 300 datë 08.04.2015, i cila ka hequr kufizimet teknologjike.

5. Nga kjo rishpërndarje spektri, ka një përfitim shumë të rëndësishëm, që konsiston në lirim të disa kanaleve sigurie të frekuencave, që përdoren si ndarje mes spektrave (pjesëve) të secilit operator, për shmangien e interferencave. Këto kanale sigurie, përbëjnë një total prej 2 MHz sasi spektri dhe konkretisht:
  - 1,2 MHz në brezin 900 MHz;
  - 0,4 MHz në brezin 1800 MHz;
  - 0,4 MHz në brezin 2100 MHz;

Për një përfitim maksimal, teknikisht këta kanale duhet të grupohen, në mënyrë që dy pjesët e tjera të spektrit të dy operatorëve celularë, të kenë vijim të pandërprerë dhe të përdoren në mënyrën më maksimale efikente. Për këtë sasi spektri (totali 2 MHz), AKEP do të ndjekë procedurat përkatëse ligjore, për dhënien në përdorim të këtij spektri.

### **A R S Y E T O N:**

6. Bazuar në nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, AKEP është autoriteti i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, përgjegjës për të nxitur/promovuar konkurrencën efikente me qëllim dhe përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe për lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e brezave të frekuencave sipas Planit Kombëtar të Frekuencave (miratuar me VKM Nr. 1187, datë 24.12.2020), si dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave (miratuar me Vendimin nr. 6, datë 31.03.2022 të Këshillit Drejtues të AKEP).
7. Bazuar në nenin 5, pika 2 dhe nenin 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”, përcaktohet qartësisht objektivi strategjik për nxitjen e administrimit dhe përdorimit efikent të spektrit radio, për të përmbushur në kohë dhe më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike, si dhe përmirësimi i fleksibilitetit në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja.
8. AKEP, vlerëson se objektivat që kërkohen të arrihen, fokusohen ngushtësisht tek përdorimi efikent i spektrave të sipërcituar, si objektivi rregullator i përcaktuar në pikën 3 e), të nenit 7, të Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe këtë mënyrë duke nxitur investimet për një mbulim dhe një cilësi shërbimi më të mirë në funksion të objektivitetit të ndërlikohjes me cilësi dhe shpejtësi të lartë, prioritet i politikave sektoriale.
9. Rishpërndarja e spektrit, duke ruajtur të njëjtën sasi spektri të caktuar më parë dhe pa ndryshuar afatet e vlefshmërisë të përdorimit të secilit spektër, liron sasi spektri të konsiderueshme, në secilin prej brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, sipas pikës 5 më sipër, gjë e cila përbën përfitim me interes publik, për faktin që kanalet që lirohen, mund të merren si të drejta nga një operator i ri ose nga një operator aktual celular.
10. Së fundmi, kërkesat e dy sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe One Albania sh.a, për ndryshime në autorizimet individuale, vijnë në përputhje me shkronjat a, b, c, të pikës 1 dhe pikën 2 të nenit 75 “Ndryshimet në autorizimin individual” të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, i ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1, neni 114 dhe pikës 1, të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, K.Pr.A, dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP;

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit eficient të këtyre frekuencave, sipas Anekseve 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur.
2. Pas rishpërndarjes, sasi të e secilit spektër, afatet respektive të vlefshmërive, dhe kushtet e përcaktuara në to, për sipërmarrësin One Albania sh.a, nuk ndryshojnë.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat përgjegjëse në AKEP për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Tomi Frashëri</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Lorenc Bako</b>

**ANEKS 1:**

**Brezi i frekuencave 900 MHz, i sipërmarrësit One Albania sh.a dhe afati i vlefshmërisë:**

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Sasia totale e spektrit (MHz)	Teknologjia	Afati i vlefshmërisë
<b>One Albania sh.a</b>	900 MHz	880-899.8	925-944.8	20 MHz i çiftuar	FDD	Për 4 MHz: 25.06.2024  Për 8 MHz: 19.08.2029  Për 8 MHz: 01.03.2034

**ANEKS 2:**

**Brezi i frekuencave 1800 MHz, i sipërmarrësit One Albania sh.a dhe afati i vlefshmërisë:**

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Sasia totale e spektrit (MHz)	Teknologjia	Afati i vlefshmërisë
<b>One Albania sh.a</b>	1800 MHz	1710-1744.8	1805-1839.8	35 MHz i çiftuar	FDD	Për 4.5 MHz: 25.06.2024  Për 9 MHz: 19.08.2029  Për 19.3 MHz: 01.04.2030  Për 2.2 MHz: 01.03.2034

**ANEKS 3:****Brezi i frekuencave 2100 MHz, i sipërmarrësit One Albania sh.a dhe afati i vlefshmërisë:**

<b>Sipërmarrësi</b>	<b>Brezi i frekuencave</b>	<b>Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)</b>	<b>Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)</b>	<b>Sasia totale e spektrit (MHz)</b>	<b>Teknologjia</b>	<b>Afati vlefshmërisë</b>
<b>One Albania sh.a</b>	2100 MHz	1950-1980	2140-2170	30 MHz i çiftuar	FDD	Për 15 MHz: 30.10.2026  Për 15 MHz: 30.11.2027
		1905-1915		10 MHz i paçiftuar	TDD	Për 5 MHz: 30.10.2026  Për 5 MHz: 30.11.2027